

Pyetjet 1

1.Nje pasqyre financiare e kompletuar duhet te perfshije?

Pasqyren e Bilancit te Gjendjes, Pasqyren e Ardhurave (bilanci i suksesit), Pasqyren mbi ndryshimet ne ekuit (kapital), Pasqyren e Cash Flow-it (rrjedhes se parase), Politiken Kontabel dhe Shenimet Sqaruese.

2.Pasqyra e Bilancit te Gjendjes duhet te perfshije se paku keto zera?

Patundshmerite, impiantet dhe pajimet, Pasurine e paprekshme, Stoqet, Llogarite e arketueshme (bleresit), Keshi (parate e gatshme), Investimet (depozitat e afatizuara), Llogarite e arketueshme (furnitoret), Detyrimet tatimore, Provizionet, Interesin nga detyrimet jokorente, Detyrimet ndaj kredive, Kapitalin e Emetuar dhe Rezervat, etj.

3.Pasqyra e te ardhurave duhet te perfshije se paku keto zera?

Te Hyrat nga Veprimtaria e Firmes (p.sh te hyrat nga shitja e mallrave), Kategorite themelore te shpenzimeve nga Veprimtaria, Fitimi (humbja) nga Veprimtaria, Shpenzimet financiare , Shpenzimet e Tatimit ne Fitim, Te hyrat Tjera, Zerat e Jashtzakonshem, Fitimi (humbja) neto per periudhen raportuese.

4.Ne pasuri jokorente bejne pjese?

Patundshmerite, impiantet dhe pajimet, Pasurite e dhena ne Lizing, Investimet Financaire Afatgjata (blerja e aksioneve, e obligacioneve, etj), Pasuria e paprekshme (shenja tregtare, goodwill, etj), etj.

5.Ne detyrimet korente bejne pjese?

Mbiterheqjet bankare, Llogarite e pagueshme (furnitoret), Shpenzimet e grumbulluara, Detyrimet ndaj dividends, Detyrimet tatimore, Detyrimet ndaj pagave te puntoreve, etj.

6.Rrjedha e parase se gatshme (cash flow) nga aktivitetet investuese perfshine?

Arketimet ne para te gatshme nga shitja e patundshmerive, impianteve dhe pajimeve dhe pasurise se paprekshme.

Arketimet ne para te gatshme nga shitja e kryegjese ose e instrumenteve te borxhit nerrmarjeve te tjera.

Arketimet ne para te gatshme si pasoje e ripagimit te avanseve dhe kredive dhene paleve te tjera.

Pagesat me para te gatshme per blerjen e patundshmerive, impianteve dhe pajimeve dhe pasurise se paprekshme.

Pagesat me para te gatshme per blerjen e kryegjese ose instrumeteve te borxhit nga nderrmarjet tjera.

Pagesat me para te gatshme per avanset dhe kredite dhene paleve te tjera.

7.Perkufizimi i kontabiliteti menaxherial?

Kontabiliteti menaxherial perkufizohet si nje proces identifikimi, matje, akumulimi, analizimi, pergatitje, interpretimi dhe komunikimi te informacionit financiare dhe jofinanciare te perdorur nga menaxhmenti per te planifikuar, vlersuar dhe kontrolluar. Zemer e kontabiliteti te menaxhmentit eshte kontabiliteti i kosos, pra eshte vet kostoja.

8.Cilat parime dhe procedura te kontabiliteti financiare mund ti zbaton edhe kontabiliteti menaxherial?

Teknikat e zhvlersimit, Procedurat e grumbullimit dhe shperndarjes se parave, Metodatat e vlersimit te Stoqueve, Njohja e Mjeteve dhe Detyrimeve, etj.

9.Per tu marre me konkurencen globale e cila eshte ne rritje, u zhvilluan 4 filozofi te reja:

- 1)Teknika afariste “pikerisht” (JIT), 2)Menaxhimi i teresishem i cilesise,
- 3)Menaxhimi i bazuar ne veprimtari, 4)Permirsimi i vazhdueshem

10.Ne shpenzimet prodhuese perfshihen te gjitha shpenzimet e lidhura me procesin e prodhimit. Cila skeme i ndan ato ne tri grupe?

Skema me e thjeshte i ndan ato ne tri grupe:

1)Shpenzimet direkte materiale (p.sh mund te jete shtresat e metalit per automobila, mielli per buke, etj), materialet direkte jane ato qe shendrohen ne perberes te produktit te gatshem.

2)Shpenzimet direkte te puntoreve (p.sh. shpenzimet e puntoreve ne prodhim kane te bejne me mirembajtes, menaxher dhe mbikqyres, puntore krahu si ngarkues dhe shkarkues, etj.)

3)Shpenzimet indirekte te prodhimit (shpenzimet e pergjithshme te fabrikes).

11.Shpenzimet e puntoreve direkt jane?

Shpenzimet e puntoreve ne prodhim kane te bejne me mirembajtes, menaxher dhe mbikqyres, puntore krahu si ngarkues dhe shkarkues, dhe puntore tjere te kyqur direkt ne formimin e produktit. Pagat e ketyre njerzve duhet llogaritur si shpenzime te prodhimit dhe perfundimisht si shpenzime te produkteve te gatshme sepse vet keta njerez jane pjese e procesit te prodhimit. Ne shpenzimet e puntoreve direkt perfshihen te gjitha shpenzimet e puntoreve te cilat i mvishen nje produkti.

12.Shpenzimet e permbledhura kundrejt atyre reale?



Shpenzimet e buxhetuara (permbledhura) jane shpenzime **te paramenduara per nje periudhe te ardhmen**. Shpenzimet reale jane shpenzime te cilat **jane shkaktuar dhe vertetuar per kete arsye edhe quhen reale**.

13.Kostoja e prodhimit kundrejt kosos periodike?

Shpenzimet e prodhimit **shkaktohen gjate prodhimit** dhe mund te **perfshihen ne stoqe**. Ndersa **shpenzimet periodike jane shpenzime apo burime te shfrytezuara gjate periodes se caktuar**, ato nuk perfshihen ne stoqe, shpenzimet periodike nuk perdoren per percaktimin e kosos per njesi gjate vendosjes te gjendjes se stoqeve.

ARBER HOTI